

## 8 Formatet e Uljes që Duhet të Dini për Eventin Tuaj

Formati i uljes në event mund të fuqizojë ose mund të prish marrëveshje, marrëdhënie, madje edhe qëllimet e eventeve. Dhe kjo varet se ku të ftuarit ulen dhe nga përzgjedhja e duhur e formatit për llojin e takimit, konferencës, trajnimit apo eventit të caktuar.

Lexoni për të zbuluar 8 formatet që duhet të dini patjetër për mënyrën e uljes në eventin tuaj dhe gjithashtu këshillat nga ekspertët e eventeve. Gjithashtu, mësoni rëndësinë që ka formati i uljes në event dhe sa mund ti ndihmoj organizuesit të krijojnë skica të ndryshme për ta bërë eventin sa më produktiv dhe efikas.



### Si mund të zgjedhim formatin e eventit?

Formati i eventit varet në bazë të çfarë aktiviteteve janë planifikuar të trajtohen në event dhe gjithashtu sa mund të zgjasë eventin duke ditur të gjitha specifikat që kanë kërkuar të ftuarit. Psh., një konferencë 1-javore, me shumë tema nuk mund të funksionoj me një mënyrë të uluri në formë të lirë, por një workshop kreativ një-ditor për një ekip të vogël, mundet.

Mos harroni që formati i uljes që ju zgjidhni, varet nga hapësira që keni, qëllimi i eventit tuaj, dhe çfarë materialeve keni në dispozicion.

# SOMEETINGS

## 1. FORMATI CHEVRON



Formati Chevron, përfshin dy anë ku secila anë të ketë karrige dhe një ndarje në mes. Një strategji e suksesshme për shume organizator që përdorin këtë stil për të krijuar një fokus të pastër ndaj folësit kryesor, dhe strategjikisht pjesëmarrësit mund të grupohen për diskutime.

### Avantazhet:

- Të gjithë mund të shikojnë dhe degjojnë folësin
- Maksimizon hapësirën duke përdorur rreshta me kënd
- Më e mira për të dy palët për prezantime

### Disavantazhet:


- Jo ideale për diskutime në grupe të mëdha
- Pjesëmarrësit mund të kenë probleme me pamjen nëse ulëset nuk janë të vendosura mirë

### Ideale për:

- Trajnimet
- Prezantime me pjesëmarrjen e dëgjuesve
- Konferencat

# SOMEETINGS

## 2. AUDITOR



Një organizim ulësesh i stilit të auditorit përfshin ulëse ose reshta karrigesh të integruara me pamje me një pikë të vetme fokusi, e cila është zakonisht një skenë profesionale ose një podium. Përfitoni nga hapësira e skenës dhe krijoni një sfond që do të jetë tërheqës për fotografi ku mund të duket logo ose ajo çfarë po prezantohet.

### **Avantazhet:**

- Perfekte për grupe të mëdha, leksione ose seri folësish dhe ceremoni

### **Disavantazhet:**


- Zëri shpesh mund të jetë një problem
- Pjesëmarrja e auditorit ose të folurit në grup mund të jetë jo e këndshme

### **Ideale për:**

- Dhënie çmimesh
- Konferencat për shtyp
- Lancime produkti

# SOMEETINGS

## 3. BANKET



Formati banket do të thotë të përdorësh tavolina rrethore të ndara në mënyrë të barabartë përgjatë gjithë hapësirës. Mos harroni që formati i banketit zakonisht akomodon 8-10 persona. Për rezultat më të mirë, bashkoni bashkë persona që njihen me njëri tjetrin dhe kanë marrëdhënie të barabartë ose familjare. Përndryshe, ulni persona që kanë interesa të përbashkëta si qëllime projektesh që inkurajojnë komunikime naturale ose hobi të ndryshëm.

### **Avantazhet:**

- Socializimi është i lehtë dhe komod
- Ideale për network dhe relaksuese

### **Disavantazhet:**


- Çdo tavolinë merr pamjen e një ishulli, duke e bërë të vështirë bashkeveprimin me tavolinat e tjera nëse ata e kerkojne këtë bashkeveprim.

### **Ideale për:**

- Dasma
- Festa
- Dhënie çmimesh
- Bankete
- Evente bamirësie

# SOMEETINGS

## 4. BOARDROOM



Ky format përbëhet nga një tavolinë e gjatë, për persona që duhet të ulen përballë njëri tjetrit. Duhet të keni parasysh principet e llojit të konferencës kur të krijoni këtë mënyrë ulje, që janë si më poshtë:

- Personi kryesor i mbledhjes duhet të ulet në krye të tavolinës
- Këshilltarët më të afërt të personave të rëndësishëm duhet të ulen në krahe
- Njerëzit në mes ose në anën e kundërt duhet që pjesën më të madhe të kohës të dëgjojnë më shumë se sa të flasin,
- Çdokush që ulet përballë personave të rëndësishëm ka të ngjarë të ndihet i prirur të mos jetë dakord me ta, ose në të kundërt ata duhet të jenë mbështetës verbal në mënyrë që të tjerët ta marrin parasysh.

### Avantazhet:

- Lehtëson diskutimin
- Fokusi i drejtohet një personi
- Ofron opsione strategjike për takimet e biznesit

### Disavantazhet:

- Jo ideale për prezantime të gjata vizuale
- Mund të çojë në mosmarrëveshje në grup nëse personat e rëndësishëm dhe personi që ulet përballë nuk e shohin njëri tjetrin sy më sy

### Ideale për:

- Takime me ide të shumta
- Takimet e grupeve të vogla
- Takime strategjike

# SOMEETINGS

## 5. CABARET



Një kërkim i kryer nga Universiteti Cornell zbuloi se kur ulesh ose kur je afër një personi, fizikisht, në këmbë ose ulur, të bën të ndihesh dhe emocionalisht më afër, e cila shpjegon pse ky format ulje në evente të ndihmon të ndërtosh marrëdhënie. Edhe nëse zgjedh tavolina të larta koktejl për të gjithë hapësirën ose i mikson bashkë me mënyra të tjera uljesh, sigurohuni që ti vendosni karriget në formën U me një hapësirë në mes që të ndihmon të fokusohesh në qendër.

### **Avantazhet:**

- Te ftuarit mund të qëndrojnë të fokusuar në prezantime dhe njëkohësisht të socializohen
- Ofron një ndjesi të qetë dhe organike

### **Disavantazhet:**


- Nuk maksimizon hapësirën

### **Ideale për:**

- Dhënie çmimesh
- Trajnime

# SOMEETINGS

## 6. Classroom - Klasse



Një studim i botuar në Psikologjinë Sociale të Edukimit vërtetoi se 'mësuesit duhet të informohen mbi efektin interferues që ka mënyra e uljes në klasë në sjelljet akademike dhe shoqërore e studentëve'. Kjo do të thotë që planifikuesit e eventeve gjithashtu duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë llojit të organizimit të ulëseve që ata zgjedhin, pasi ai ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë dhe veprimet e pjesëmarrësve në një mjedis pune. Për rezultate më të mira, kufizoni tavolinat e vogla në katër pjesëmarrës dhe lini të paktën tre metra hapësirë midis secilës ulëse në tavolina të gjata.

### **Avantazhet:**

- Vëmendja është në pjesën e përparme të sallës
- Motivon natyrshëm pjesëmarrësit për të mësuar
- Ideale për marrjen e shënimeve

### **Disavantazhet:**

- Ka tendencë të duket e mbipopulluar nëse pjesëmarrësit nuk janë të ulur në mënyrën e duhur


### **Ideale për:**

- Trajnime në grup
- Çertifikatat personale
- Mbledhje për informacione produktesh

# SOMEETINGS

## 7. *HOLLOW SQUARE* - Katror me qendër bosh

### Hollow Square



E ngjashme me stilin në formë banketi dhe forme U-je, stili katror i zbrazët duket ekzaktësisht sic tingëllon. Të gjithë mund ta shohin njëri -tjetrin duke ruajtur një distancë të rehatshme, gjë që e bën ideale për të ngrënë ushqim ose për të punuar në laptop. Përdorni këtë lloj organizimi të uljes për grupet që do të ishin shumë të ngarkuar me njerëz në një tavoline të rregullt banketi, për t'u dhënë hapësirë atyre që ulen.

#### **Avantazhet:**

- Pozitive për të ngrënë dhe për të punuar
- Të gjithë pjesëmarrësit janë të dukshëm për njëri - tjetrin dhe mund të kenë diskutime të rehatshme

#### **Disavantazhet:**

- Nuk funksionon mirë me prezantimet
- Nuk ka vend kryesor të qartë
- Nuk maksimizon hapësirën e sipërfaqjes

#### **Ideale për:**

- Takime bashkëpunuese me më pak se 30 të ftuar
- Dreka pune
- Mbledhje



# SOMEETINGS

## 8. U-SHAPED - Forme U



Formati i uljes në formë U-je përbëhet nga një grup tavolinash në formën e një kutie me një qendër bosh dhe një fund të hapur. Kompensoni hapsirën bosh duke vendosur materiale dekorative ose prezantuese në mure. Përdorni këtë lloj organizimi të uljes për pjesëmarrësit që kanë punuar së bashku më parë ose po planifikojnë ta bëjnë këtë në të ardhmen e afërt për të lehtësuar ndërtimin e marrëdhënieve.

### **Avantazhet:**

- Ideale për prezantime dhe bashkëpunim në grup
- Të gjithë mund ta shohin njëri -tjetrin në çdo kohë
- Publiku mund të bashkëveprojë me lehtësi me folësit

### **Disavantazhet:**

- Kërkon një asistent ose udhëheqës të caktuar për të ndihmuar në vazhdimin e dialogut
- Jo i përshtatshëm për grupe të mëdha mbi 30 pjesëmarrës

### **Ideale për:**

- Mbledhje në grup
- Prezantimet

# SOMEETINGS

**Krijoni formatin dhe organizimin perfekt të uljes së pjesëmarrësve për çdo event!**



Tani që jeni njohur me disa nga formatet kryesore të uljes në evente, avantazhet dhe disavantazhet e secilës, është koha për të parë dhe provuar nga afër këtë eksperiencë. Për një event sa më profesional, ju ftojmë në Someetings, për të organizuar eventin tuaj në mënyrë sa më profesionale dhe perfekte.



[www.someetings.com](http://www.someetings.com)



Someetings



Someetings



Someetings